

RREGULLORE NR. 2001/3

UNMIK/REG/2001/3

12 janar 2001

MBI INVESTIMET E HUAJA NË KOSOVË

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në përputhje me autorizimin që i është dhënë me [Rezolutën nr. 1244 \(1999\)](#) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh [Rregulloren nr. 1999/1](#), të ndryshuar, të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë mbi Autoritetin e Administratës të Përkohshme në Kosovë të datës 25 korrik 1999,

Me qëllim të rindërtimit dhe rimëkëmbjes së ekonomisë së Kosovës dhe krijimit të një tregu të qëndrueshëm ekonomik për tërheqjen e investimeve të huaja,

Shpall sa vijon:

Neni 1

QËLLIMI

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është të krijojë disa garanci të sigurta ligjore të nevojshme për ta bërë Kosovën më tërheqëse për investimet e huaja.

Neni 2

PËRKUFIZIME

2.1 Sipas kësaj Rregulloreje:

“Autoritete” do të thotë Administra e Përkohëshme e Kosovës dhe trashëguesit e saj.

“Organizatë afariste” do të thotë çfarëdo organizate e themeluar sipas ligjit në fuqi në Kosovë, me qëllim të ushtrimit të afarizmit ligjor.

“Organizatë vendëse afariste” do të thotë organizatë afariste që nuk është investim i huaj.

“Trajtim kombëtar” do të thotë se përkitazi me të gjitha ligjet, rregulloret, urdhëresat dhe aktet tjera që kanë forcën ligjore në Kosovë, investimet e huaja në Kosovë nuk do të trajtohen më pak të favorshme se organizatat e ngjashme afariste vendëse.

“Vlera e akcioneve” do të thotë interesi pronësor në një organizatë afariste.

“Kontrolli i huaj” do të thotë ushtrimi i së drejtës së investitorit të huaj mbi pesëdhjetë për qind (50 %) të të drejtave menagjuese të një investimi të huaj.

“Investimi i huaj” do të thotë organizata afariste që është së paku njëzetepesë (25 %) për qind në pronësi të investitorit të huaj.

“Investitori i huaj” përfshin:

- (a) (a) çdo person fizik, banor apo qytetar të ndonjë shteti të huaj;
- (b) (b) çdo subjekt ligjor që:
 - (i) (i) është themeluar dhe regjistruar sipas ligjit të shtetit të huaj;
 - (ii) (ii) është themeluar sipas ligjit në fuqi të Kosovës me adresë zyrtare apo me qendren e tij të afarizmit në ndonjë shtet të huaj ose
 - (iii) (iii) është investitor i huaj;
- (c) (c) një shtet të huaj ose njësinë administrative të tij dhe
- (d) (d) një subjekt ligjor të krijuar nga kontrata ndërqeverisëse ose marrëveshja.

“Valutë e përdorimit të lirë” do të thotë çdo valutë e caktuar nga Fondi Ndërkombëtar Monetar.

“LIBOR”^[1] do të thotë Kursi i Ofruar Ndërbankar i Londres.

“Person” nënkupton personin fizik dhe personin juridik.

“Marrje ” nënkupton shpronsimin, nacionalizim, dënim, kërkesë, taksë jasht mase apo taksë përsëritëse, ose masat kontrolluese që kanë ndikim konfiskues, qoftë vetëm apo në grupe, për një investim të huaj nga autoritetet, por nuk përfshin administrimin e pasurisë së UNMIK-ut sipas [Rregullores së UNMIK-ut nr.1999/1](#), të ndryshuar.

2.2. Siç është përdorur këtu, njëjësi përfshin shumësin dhe shumësi përfshin njëjësin, përveç nëse konteksti e kërkon ndryshe. Përemëri vetor “ai” përfshin nësoj si përemërin vetor “ajo”, “ky”, “kjo”, dhe “atij”, “ate” ashtu edhe “asaj”, “ate” dhe “atë”, përveç nëse konteksti e kërkon ndryshe.

Neni 3
TRAJTIMI KOMBËTAR

^[1] “LIBOR” = London Interbank Offered Rate

Parimi sipas të cilit rregullohen investimet e huaja është parimi i trajtimit kombëtar. Në veçanti përfshin, por pa ndonjë kufizim:

- (a) (a) Organizatat afariste të përkufizuara si investime të huaja sipas kësaj rregulloreje organizohen në të njëjtën mënyrë si organizatat vendëse afariste;
- (b) (b) Investimet e huaja i nënshtrohen miratimit të autoriteteve, vetëm atëherë kur një miratim i tillë kërkohet edhe për organizatat e ngjashme vendëse afariste;
- (c) (c) Investitori i huaj mund t'i transferojë të drejtat pronësore, duke përfshirë edhe lejet, personave të tjerë të kualifikuar juridikisht në të njëjtën mënyrë dhe masë si personat vendës;
- (d) (d) Investimet e huaja kanë të drejta të njëjta në blerjen e pasurisë së patundshme jobujqësore për banim dhe pasuri tjetër të patundshme si organizatat vendëse afariste;
- (e) (e) Investitorët e huaj që kanë më pak se shumicën e akcioneve në investimet e huaja merren në mbrojtje sikurse akcionarët e vegjël vendës në përputhje me ligjin në fuqi;
- (f) (f) Në asnjë rast investimi i huaj nuk mund të të tatimohet në mënyrë më pak të favorshme se një organizatë e ngjashme afariste vendëse;
- (g) (g) Të drejtat e investitorëve të huaj nuk mund të dëmtohen me faktin se autoritetet mund të jenë palë e një kontrate investuese dhe
- (h) (h) Investitorët e huaj mund të themelojnë organizata ndihmëse, degë dhe zyra përfaqësimi në të njëjtën mënyrë dhe masë si organizatat vendëse afariste.

Neni 4

PARASHTRIMI I KËRKESAVE

Për investimet e huaja mund kërkohet paraqitja i një deklarate autoriteteve përkatëse për identifikimin e palëve kryesore dhe natyrën e investimit vetëm për qëllim të mbledhjes së shënimeve statistikore për identifikimin dhe fitimin e privilegjeve të statusit të investimit të huaj. Kurrfarë kërkesash tjera nuk mund të kërkohen për investimet e huaja pos atyre që kërkohen për organizatat e ngjashme afariste vendëse.

Neni 5

FUSHËVEPRIMI SEKTORIAL I INVESTIMEVE TË HUAJA

Me përjashtim të fushëveprimeve specifike të paraqitura në nenin 6, investitorët e huaj mund t'i kenë në pronësi të plotë dhe t'i kontrollojnë plotësisht organizatat afariste në të gjitha sektoret e ekonomisë kosovare. Investimet e huaja në sektorët strategjikë dhe specifikë u nënshtrohen kërkesave të njëjta të licensimit nga autoritetet si organizatat vendëse afariste.

Neni 6

KUFIZIMET NË INVESTIMET E HUAJA

Investitorët e huaj nuk mund të kenë më tepër se katërdhjetenëntë përqind (49 %) të pronësisë apo të kontrollojnë interesin në organizatat afariste që prodhojnë apo shpërndajnë produkte ushtarake.

Neni 7

MBROJTJA PËRKITAZI ME MARRJET OVERRIDING

7.1. Investimet e huaja nuk mund të mirren nga autoritetet përveç rasteve të parapara në paragrafet vijuse. Autoritetet mund të përvetësojnë investimin e huaj vetëm nëse:

- (a) (a) bëhet për ndonjë qëllim primar publik;
- (b) (b) është mënyra e vetme për të përmbushur atë qëllim primar publik;
- (c) (c) është bërë në baza jodiskriminuese, në përputhje me ndonjë proces të rregullt ligjor dhe
- (d) (d) shoqërohet me kompensim të menjëhershëm, adekuat dhe efikas për investitorin e huaj.

7.2 Investitori i huaj, i cili pohon se investimi i tij i është nënshtruar marrjes, ka të drejtë për shqyrtim të shpejtë gjuqësor apo administrativ apo shqyrtim para autoriteteve tjera kompetente, në përputhje me një proces të rregullt ligjor. Nëse në shqyrtim vendoset se pohimi është me vënd, autoriteti që ka shqyrtuar rastin e vlerëson vlerën e kërkesës dhe urdhëron pagesën e kompensimit në kohën e duhur. Kompensimi i tillë duhet të jetë i barabartë me vlerën reale të tregut për atë investim të huaj, i cili është objekt i marrjes menjëherë para marrjes, por nëse informatat lidhur me marrjen janë bërë publike para marrjes, atëherë vlera e investimit të përvetësuar do të llogaritet, nëse investitori i huaj e zgjedhë këtë opcion, si vlera e tij reale në treg menjëherë para ngjarjes kur marrja është bërë publike.

7.3 Kompensimi bëhet në valutë konvertibile dhe përfshin interesin e një kiste njëvjeçare të LIBOR-it për periudhën ndërmjet datës së marrjes dhe datës së pagesës së plotë të kompensimit.

7.4 Si alternativë e shqyrtimit gjyqësor të lartëpërmendur, vlera reale e tregut të lëndës që i nënshtrohet marrjes mund të përcaktohet edhe me mjete tjera të dakorduara

Neni 8

ZHDËMTIMI PËR HUMBJET E JASHTËZAKONSHME

Investimet e huaja që pësojnë humbje si rezultat i luftës apo konflikteve tjera ushtarake, revolucionit, situatave emergjente, luftave qytetare, demonstratave qytetare apo rrethanave tjera të ngjashme, kanë të drejta ligjore dhe mbrojtje jo më pak të favorshme se ato që vlejnë për organizatat vendëse afariste.

Neni 9

GARANCITË PËR PËRDORIMIN E PAKUFIZUAR TË TË ARDHURAVE

9.1 Investitorët e huaj kanë të drejta të pakufizuara t'i përdorin investimet e tyre dhe çfarëdo të ardhurash të fituara nga ato investime në mënyrë të ligjshme për çfarëdo qëllimi të ligjshëm. Të gjithë fitimet e ligjshme nga veprimtaria e një investimi të huaj mund të mbahen nga investitor i huaj, përveç tatimit dhe detyrimeve të tjera, apo t'i sistemojnë për ndonjë qëllim tjetër, duke përfshir edhe dërgimin e tyre në atdhe apo konvertimin e tyre në ndonjë valutë tjetër në cilindo treg vendës apo të huaj.

9.2 Investimet e huaja kanë të drejta të njejta si organizatat vendëse afariste në hapjen e llogarive bankare. Nuk ka kurrfarë kufizimesh ligjore për valutat në të cilat hapen dhe veprojnë ato llogari bankare. Në varësi të tatimeve dhe detyrimeve të tjera, investitorët e huaj mund t'i transferojnë pa vonesë fondet e fituara në mënyrë të ligjshme në Kosovë dhe jasht Kosovës, pavarësisht nga origjina e tyre.

Neni 10

MBROJTJE NGA ABUZIMET E PRONËSISË INTELEKTUALE

Autoritetet zbatojnë shenjën mbrojtëse të prodhimit, të drejtën e autorit dhe ligjet e patentimit, dhe çfarëdo të drejtash autoriale ndërkombëtare në fuqi.

Neni 11

E DREJTA E INFORMIMIT PUBLIK

Investitorët e huaj kanë të drejtë t'i përdorin në mënyrë të drejtëpërdrejt dhe të hapët të gjitha ligjet dhe vendimet e gjykatave ose organeve tjera gjyqësore dhe në çfarëdo informate tjetër publike që ka lidhje të logjikshme me interesat e investimeve të tyre.

Neni 12

MBROJTJA KUNDËR ZBATIMIT RETROAKTIV TË LIGJEVE TË PAFAVORSHME

Nuk mund të zbatohet në mënyrë retroaktive asnjë ligj, rregullore, udhëzim apo akt tjetër që ka fuqinë e ligjit me qëllim të imponimit të kushteve më pak të favorshme sesa ato ekzistuese në çfarëdo investimi të huaj në momentin kur kryhen ato investime të huaja.

Neni 13

NDALIMI ME LIGJ I FAVORITIZMIT DHE DISKRIMINIMIT

Asnjë zyrtar, agjenci, ligj apo autoritet tjetër ligjor nuk mund t'i diskriminojë investitorët e një vendi të caktuar, apo t'u jep tretman të veçantë investuesëve për shkak të shtetit, prejardhjes ose kombësisë së tyre.

Neni 14

ZBATIMI I LIGJEVE TË KOSOVËS

Nëse nuk parashihet ndryshe me këte rregullore, investimet e huaja duhet t'u përmbahen ligjeve të njëjta që zbatohen nga organizatat vendëse afariste. Në veçanëti dhe pa kurrfarë kufizimi:

- (a) (a) Të gjitha licencat apo lejet tjera të nevojshme për kryerjen e veprimtarive të veçanta afariste që kërkohet për organizatat vendëse afariste, kërkohen edhe për investimet e huaja;
- (b) (b) Investimet e huaja duhet t'i mbajnë librat e veprimtarisë afariste dhe regjistrimet në pajtim me të njëjtat standarde kontabël që vlejné për organizatat e ngjashme vendëse afariste;
- (c) (c) Investimet e huaja u nënshtrohen kushteve të njëjta të sigurimit që vlejné për organizatat e ngjajshme vendëse afariste;
- (d) (d) Investimet e huaja tatimohen në të njëjtën mënyrë si organizatat e ngjashme vendëse afariste.

Neni 15

BESNIKËRIA NDAJ PARIMEVE TË ETIKËS AFARISTE

Investitorët e huaj duhet t'i respektojnë parimet e afarizmit që janë në pajtim me parimet e Konventës mbi larjen e parave, hetimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e të ardhurave të fituara nga veprimtaria kriminale (Këshilli Evropës, Strasburg, 8 korrik 1990), Konventës për luftimin e mitëdhënies të nëpunësve të qeverive të huaja në transaksionet ndërkombëtare afariste (Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik, Paris, 21 nëntor 1997), Konventës të ligjit penal mbi korrupsionin (Këshilli i Evropës, Strasburg, 27 janar 1999), Konventës civile mbi korrupsionin (Këshilli Evropës, Strasburg, 4 nëntor

1999). Shkelja e parimeve të këtyre konventave mund të jetë shkak për përjashtim të kryerjes së veprimtarive afariste në Kosovë.

Neni 16

PUNA DHE PUNËSIMI

16.1 Punonjësit e investimeve të huaja në Kosovë, pavarësisht nga kombësia e tyre, u nënshtrohen ligjeve në fuqi në Kosovë.

16.2 Marrëdhëniet e punësimit ndërmjet investimeve të huaja dhe punonjësve të tyre rregullohen me marrëveshjet e tyre të punës. Këto marrëveshje të punës nuk mund të caktojnë standarde më të ulta se kërkesat e detyrueshme në Kosovë. Koncepti i punonjësit vetëqeverisës nuk vlen për investimet e huaja.

16.3 Investimet e huaja kanë të drejtë të punësojnë persona juridikë dhe persona fizikë, duke përfshirë qytetarë të huaj, për të drejtuar investimet dhe aktivitetet afariste të tyre.

16.4 Investitorët e huaj kanë të drejtë të punësojnë menaxherë dhe personel të çdo kombësie.

Neni 17

ZGJIDHJA E KONTESTEVE INVESTUESE

Gjykatat e Kosovës kanë juridiksion për zgjidhjen e kontesteve afariste. Pavarësisht nga ajo që u tha më lart, palët e një investimi të huaj mund të saktësojnë çfarëdo arbitrazhi apo procedure tjetër për zgjidhjen e kontestit për të cilën pajtohen dhe nëse një marrëveshje e tillë jep rezultat, çdo vendim që del nga një procedure e tillë e dakorduar është përfundimtare dhe e detyrueshme, pa kurrfarë shqyrtimi apo ankese në çfarëdo mënyre, në ndonjë gjykatë kompetente të Kosovës.

Neni 18

HYRJA NË FUQI

Kjo rregullore hyn në fuqi më 12 janar 2001

Bernard Kouchner,
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm